

V E N D I M
Nr. 64, datë 23. 12. 2002

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË PUNËS SË KOMISIONIT PARLAMENTAR BIPARTIZAN
PËR SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË OSBE-SË/ODIHR-IT PËR
ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2001**

Në mbështetje të neneve 30 e 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit Parlamentar (pozitë-opozitë) për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE-së/ODIHR-it,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Zgjatet afati i punës së Komisionit Parlamentar Bipartizan (pozitë-opozitë) për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve në raportin përfundimtar të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të 24 qershorit 2001 deri në 31. 3. 2003.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi